

RAPPORTO DI AUTO VALUTAZIONE

Progetto “Bukë, Kripë e Zemër – Cibo, Tradizione e Cultura: processi di co-sviluppo in aree marginali del nord e sud dell’Albania attraverso la valorizzazione dei saperi e dei prodotti tradizionali bio-mediterranei” (Albania)

RAPORTI I VETËVLERËSIMIT

Projekti “Bukë, Kripë e Zemër – Ushqimi, Tradita dhe Kultura: procese të bashkë-zhvillimit në zonat e margjinalizuara në veri dhe në jug të Shqipërisë me anë të vlerësimit të njohurive dhe prodhimeve tradicionale bio-mesdhetare” (Shqipëri)

RAPPORTO DI AUTO VALUTAZIONE

Progetto “Bukë, Kripë e Zemër – Cibo, Tradizione e Cultura: processi di co-sviluppo in aree marginali del nord e sud dell’Albania attraverso la valorizzazione dei saperi e dei prodotti tradizionali bio-mediterranei”



Projekti “Bukë, Kripë e Zemër – Ushqimi, Tradita dhe Kultura: procese të bashkë-zhvillimit në zonat e margjinalizuara në veri dhe në jug të Shqipërisë me anë të vlerësimit të njohurive dhe prodhimeve tradicionale bio-mesdhetare”

30 Aprile/Prill **2017**

Prefazione

Nei progetti di cooperazione internazionale la valutazione finale è una pratica sempre più presente e normalmente si ricorre ad esperti esterni ed indipendenti per analizzare se e quanto i risultati inizialmente previsti sono stati raggiunti.
Nel caso del progetto "Bukë, Kripë e Zemër – Cibo, Tradizione e Cultura: processi di co-sviluppo in aree marginali del nord e sud dell'Albania attraverso la valorizzazione dei saperi e dei prodotti tradizionali bio-mediterranei" (AID 10170/VIS/ALB), co-finanziato da AICS-MAECI, si è scelto l'autovalutazione,(sebbene sia una forma cui si ricorre piuttosto raramente), sia per il tipo di progetto, realizzato in due diversi territori estremi dell'Albania, con varie attività molto coinvolgenti, sia per permettere a tutti i diversi soggetti implicati in questi tre anni, dallo staff ai partners, dagli erogatori di servizi ai beneficiari, di affacciarsi ad una pratica che guardando con la massima onestà il lavoro svolto, contribuisce a migliorare la competenza professionale. Indirettamente è un piccolo contributo rivolto anche all'Albania, dove la pratica dell'autovalutazione è ancora quasi sconosciuta.
Un ringraziamento speciale va all'AICS – Agenzia Italiana per la Cooperazione allo Sviluppo di Tirana ed in particolare a Endri Xhaferaj, per il costante accompagnamento ed il sostegno ricevuto. Non c'è modo di esprimere a parole, infine, la riconoscenza che dobbiamo a Paolo Dieci - Presidente di CISP (Comitato Internazionale per lo Sviluppo dei Popoli) ed a Debora Rezzoagli - Direttrice CISP per l'Asia e l'Est Europa, per la disponibilità ad essere parte con noi in questa ultima iniziativa.

Pier Paolo Ambrosi
VIS Albania

Giorgio Ponti
CESVI Albania

Hyrje

Në projektet e kooperimit ndërkombëtar vlerësimi përfundimtar është një praktikë gjithnjë e më e pra-nishme dhe normalisht ka nevojë për ekspertë të jashtëm dhe të pavarur për të analizuar nëse dhe sa janë arritur rezultatet e parashikuara fillimisht.
Në rastin e projektit "Bukë, Kripë e Zemër – Ushqimi, Tradita dhe Kultura: procese të bashkë-zhvillimit në zonat e margjinalizuara në veri dhe në jug të Shqipërisë me anë të vlerësimit të njohurive dhe prodhimeve tradicionale bio-mesdhetare" (AID 10170/VIS/ALB), i bashkë-finacuar nga AICS – MAECI, u zgjodh vetëvlerësimi, (edhe pse është një formë, e cila përdoret relativisht rrallë), si për llojin e projektit, realizuar në dy territore të skajshme të Shqipërisë, me aktivitete të ndryshme shumë gjithëpërfshirës, ashtu edhe për të bërë të mundur që të gjithë subjektet e përfshirë përgjatë tre viteve, nga stafi tek partnerët, nga ofruesit e shërbimeve tek përfituesit, për t'iu qasur një praktike që, duke parë me ndershmërinë më të madhe punën e kryer, kontribuon në përmirësimin e kompetencës profesionale. Në mënyrë indirekte është një kontribut drejtuar edhe Shqipërisë, ku praktika e vetëvlerësimit është ende e panjohur.
Një falenderim i veçantë shkon për AICS – Agjencinë Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim në Tiranë dhe në veçanti për Endri Xhaferaj, për shoqërimin e vazhdueshëm dhe mbështetjen e dhënë. Në fund, nuk arrijmë të shprehim me fjalë sa duhet mirënjohjen ndaj Paolo Dieci – President i CISP (Comitato Internazionale per lo Sviluppo dei Popoli) dhe Debora Rezzoagli– Drejtoreshë e CISP për Azinë dhe Evropën Lindore, për gatishmërinë e të qenit pjesë e jona në këtë nismë të fundit.

Pier Paolo Ambrosi
VIS Albania

Giorgio Ponti
CESVI Albania

Sommario

1. Introduzione e sintesi delle conclusioni 5
2. La teoria del cambiamento del progetto 10
3. Riferimenti alla metodologia della valutazione 16
4. L'efficienza del progetto: analisi e raccomandazioni 21
5. La rilevanza del progetto: analisi e raccomandazioni 25
6. L'efficacia del progetto: analisi e raccomandazioni 29
7. La sostenibilità del progetto: analisi e raccomandazioni 34
8. L'impatto del progetto: analisi e raccomandazioni 38

Pasqyra e lëndës

1. Hyrje dhe përmbledhje e konkluzioneve 3
2. Teoria e ndryshimit të projektit 10
3. Referenca për metodologjinë e vlerësimit 16
4. Efikasiteti i projektit: analizë dhe rekomandime 21
5. Përshtatshmëria e projektit: analizë dhe rekomandime 25
6. Efektiviteti i projektit: analizë dhe rekomandime 29
7. Qëndrueshmëria e projektit: analizë dhe rekomandime 34
8. Impakti i projektit: analizë dhe rekomandime 38

Allegati

A. Scheda del progetto
B. Persone, istituzioni, entità incontrate durante la valutazione
C. Mappe delle aree del progetto
D. Organigramma del progetto
E. Liste analitiche dei beneficiari del progetto
F. Analisi dei prestiti erogati da Fondi BESA

Shtojca

A. Skeda e projektit
B. Persona, institucione, subjekte të takuara gjatë fazës së vlerësimit
C. Hartat e zonës së projektit
D. Organigrama e projektit
E. Lista analitike e përfituesve të projektit
F. Analiza e kredive të disbursuara nga Fondi BESA

1. Introduzione e sintesi delle conclusioni

Hyrje dhe përmbledhje e konkluzioneve

Il progetto oggetto di questa valutazione è co-finanziato dalla cooperazione italiana e realizzato da un consorzio composto dalle Organizzazioni non Governative (ONG) Volontariato Internazionale per lo Sviluppo (VIS) e Cooperazione e Sviluppo (CESVI) in Albania, nelle municipalità di Përmet e Këlcyrë nella regione di Girocastro e di Malësi e Madhe nella regione di Scutari.

Il VIS, in quanto ONG capofila, ha firmato una convenzione per la realizzazione del progetto con la Direzione Generale per la Cooperazione allo Sviluppo (DGCS) dell'allora Ministero degli Affari Esteri il 26 novembre 2013. Successivamente all'entrata in vigore e all'attuazione della legge 125 del 2014, l'entità di riferimento per conto della cooperazione italiana è divenuta l'Agenzia Italiana per la Cooperazione allo Sviluppo (AICS), sia in Italia e sia in Albania, dove esiste un ufficio nazionale dell'Agenzia.

Il progetto è stato avviato in data 15 marzo 2014 e, avendo una durata triennale, si sarebbe dovuto concludere il 14 marzo 2017; una proroga richiesta dal VIS all'AICS il 31 Gennaio 2017 e da quest'ultima approvata il 15 Febbraio 2017 ha esteso la data di chiusura del progetto al 31 Maggio 2017.

La valutazione di cui il presente rapporto espone i risultati si è realizzata a poco più di un mese di distanza dal termine delle attività.

Gli staff del VIS e del CESVI, l'ufficio di Tirana dell'AICS, le istituzioni locali, i beneficiari del progetto, altri operatori incontrati sono indicati nell'Allegato B.

Projekti, objekt i këtij vlerësimi, është bashkë-financuar nga Kooperacioni Italian dhe është zbatuar nga bashkëpunimi i dy organizatave jo-qeveritare (OJQ) Volontariato Internazionale per lo Sviluppo/Vullnetarizmi Ndërkombëtar për Zhvillimin (VIS) dhe Cooperazione e Sviluppo/Bashkëpunim dhe Zhvillim (CESVI) në Shqipëri, në Bashkitë e Përmetit dhe Këlcyrës në Qarkun e Gjirokastrës dhe në Bashkinë e Malësisë së Madhe në Qarkun e Shkodrës.

VIS, në cilësinë e OJQ-së kryesuese, ka nënshkruar një marrëveshje për realizimin e projektit me Drejtorinë e Përgjithshme të Bashkëpunimit për Zhvillim (Direzione Generale per la Cooperazione allo Sviluppo - DGCS), atëherë Ministria e Punëve të Jashtme, më 26 nëntor 2013. Që nga hyrja në fuqi dhe zbatimi i ligjit 125 të vitit 2014, njësia e referimit në emër të Kooperacionit Italian është Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim (Agenzia Italiana per la Cooperazione allo Sviluppo - AICS), si në Itali ashtu edhe në Shqipëri, ku ka një zyrë kombëtare të Agjencisë.

Projekti ka filluar me datë 15 mars 2014 dhe duke pasur një kohëzgjatje 3 vjeçare duhet të ishte përmbyllur me datë 14 mars 2017; një shtyrje afati me kërkesë të VIS drejtuar AICS me 31 janar 2017 dhe e miratuar nga kjo e fundit me datë 15 shkurt 2017 e ka shtyrë datën e përfundimit të projektit me datë 31 maj 2017.

Vlerësimi, raporti i të cilit paraqet rezultatet, është realizuar në pak më shumë se një muaj nga përfundimi i aktiviteteve.

Stafet e VIS dhe CESVI, zyra e Tiranës e AICS, institucionet vendore, përfituesit e projektit, operatorë të tjerë të takuar janë paraqitur në të Shtojcën B.

La valutazione è stata facilitata da Paolo Dieci e Deborah Rezzoagli , che hanno anche curato la stesura di un primo draft del rapporto, poi inviato al VIS e al CESVI.

I facilitatori della valutazione desiderano sinceramente ringraziare il VIS e il CESVI per l'ospitalità, l'estrema disponibilità alla collaborazione e l'accuratezza con la quale hanno predisposto la documentazione di rilievo analizzata.

Come si è già sottolineato, il progetto si è realizzato in due regioni albanesi: Scutari a nord e Girocastro a sud. Nelle aree settentrionali erano già stati realizzati interventi di sviluppo tramite il micro credito, mentre a sud precedenti iniziative di cooperazione avevano fatto affidamento soprattutto sui grant.

La diversità degli interventi realizzati nelle due aree prima dell'avvio del progetto e l'esistenza di bisogni differenziati nei due territori (ad esempio, la rete stradale al sud e l'elettrificazione al nord) hanno reso possibile sperimentare l'efficacia di un modello di intervento al fine della sua replicabilità su scala nazionale.

Il modello cui si fa riferimento è quello di una strategia fortemente integrata, all'interno della quale ogni specifica componente – credito, grant, formazione professionale, informazione e sensibilizzazione, sviluppo comunitario - rafforza e valorizza le altre.

Vlerësimi është lehtësuar nga Paolo Dieci dhe Deborah Rezzoagli , të cilët edhe u kujdesën dhe morën përsipër hartimin e një versioni të parë paraprak (draft), që më pas iu dërgua VIS dhe CESVI.

Lehtësuesit e vlerësimit dëshirojnë sinqerisht të falenderojnë VIS dhe CESVI për mikpritjen, gatishmërinë e jashtëzakonshme për të bashkëpunuar dhe për saktësinë me të cilën përgatitën dhe paraqitën dokumentacionin për t'u analizuar dhe shqyrtuar.

Siç e kemi vënë në dukje tashmë, projekti është realizuar në dy qarqe shqiptare: Shkodra në veri dhe Gjirokastra në jug. Në zonën veriore ishin realizuar më parë ndërhyrje zhvillimi përmes mikro-kredisë, ndërsa në jug nisma të mëparshme të bashkëpunimit ishin mbështetur kryesisht në grante.

Larmia e ndërhyrjeve të realizuara në të dy zonat para fillimit të projektit dhe prania e nevojave të ndryshme në dy territoret (për shembull, rrjeti rrugor në jug dhe elektrifikimi në veri) kanë bërë të mundur të provuarit dhe të përjetuarit që ka efikasiteti i një modeli ndërhyrjeje me qëllim përsëritjen (replikimin) e tij në shkallë kombëtare.

Modeli i përmendur është ai i një strategjie dhe qasjeje shumë të integruar, në të cilën çdo komponent i veçantë - kredi, grant, trajnime profesionale, informacion dhe ndërgjegjësim, zhvillim i komunitetit - forcon dhe vlerëson të tjerët.



Incontri con staff progetto/Takime të kryera me stafin e projektit





Incontri con gli attori del progetto / Takime me aktorët e projektit

Tutti gli interlocutori incontrati hanno sottolineato il fatto che il valore aggiunto del progetto sia consistito in un insieme di fattori che ne hanno contraddistinto il disaegno e la realizzazione, quali: estrema aderenza ai bisogni dei territori, trasparenza nell'allocazione delle risorse, riconoscimento del ruolo chiave delle amministrazioni pubbliche, articolazione della struttura del partenariato, tramite le due ONG, gli enti locali, Fondi BESA e la Fondazione Partnership for Development(PfD).
Rispetto ai risultati dell'esercizio valutativo, descritti nei capitoli 4,5,6,7 e 8 si possono anticipare le seguenti considerazioni.

I livelli di efficienza ed efficacia del progetto sono molto alti e le raccomandazioni formulate hanno il senso di capitalizzare il lavoro svolto al fine di valorizzare i risultati conseguiti.

Circa l'impatto e la sostenibilità – come noto gli ambiti valutativi di norma più complessi soprattutto prima della conclusione di un progetto – esistono concrete indicazioni positive, ad esempio in riferimento all'andamento del credito e alla percentuale di restituzione dei prestiti.

L'ambito valutativo rispetto al quale si registra la performance più alta è quello della rilevanza, nel senso che il progetto appare ancora più rilevante oggi rispetto al periodo in cui era stato identificato e formulato. I parametri allora assunti erano stati la rispondenza ai bisogni delle comunità e la coerenza con le priorità programmatiche degli stakeholders pubblici. Tali parametri sono stati confermati e ad essi si aggiunge una novità istituzionale di rilievo. Gli enti locali albanesi, sulla base di un orientamento del governo nazionale e di un'iniziativa sostenuta da un pool di donatori, tra i quali l'Italia, dovranno nei prossimi mesi definire piani di sviluppo territoriali. I tre enti locali incontrati hanno dichiarato che faranno tesoro delle indicazioni programmatiche ispirate dal progetto per definire i propri piani.

Të gjithë personat dhe bashkëbiseduesit e takuar kanë theksuar faktin se vlera e shtuar e projektit ka konsistuar në një sërë faktorësh që kanë karakterizuar hartimin dhe zbatimin, të tilla si: respektimi i skajshëm i nevojave të territoreve, transparenca në shpërndarjen e burimeve, njohja e rolit kyç të administratave publike kryesore, mënyra e strukturimit të partneritetit, nëpërmjet dy OJQ-ve, autoritetet vendore, Fondi BESA dhe Fondacioni Partneritet për Zhvillim(PFD).

Krahasuar me rezultatet e ushtrimit të vlerësimit, të përshkruara në kapitujt 4,5,6,7 dhe 8 mund të paraqitenn paraprakisht shqyrtimet e mëposhtme.

Nivelet e efikasitetit dhe efektivitetit të projektit janë shumë të larta dhe rekomandimet e bëra kanë kuptimin për të shfrytëzuar punën e kryer me qëllim vlerësimin e rezultateve të arritura.

Rreth impaktit dhe qëndrueshmërisë –siç dihet janë zakonisht fushat vlerësuese më të ndërlikuara sidomos para përfundimit të një projekti – ka tregues konkretë pozitivë, për shembull në lidhje me ecurinë e kredisë dhe me përqindjen e kthimit dhe shlyerjes së saj.

Fusha e vlerësimit tek e cila shfaqet performanca më e lartë është ajo e përshtatshmërisë (relevance), në kuptimin që projekti është edhe më i përshtatshëm sot krahasuar me periudhën në të cilën ishte identifikuar dhe hartuar. Parametrat e marrë në atë kohë ishin në përputhje me nevojat e komunitetit dhe në koherencë me prioritetet programore të aktorëve (stakeholders) publikë. Këto parametra janë konfirmuar dhe atyre u shtohet një risi institucionale e rëndësishme. Autoritetet vendore shqiptare, bazuar në një orientim të qeverisë kombëtare dhe të një nisme të mbështetur nga një grup donatorësh, mes të cilëve Italia, duhet të përcaktojnë në muajt e ardhshëm planet e zhvillimit të territorit. Tre autoritetet vendore të takuara kanë deklaruar se do të shfrytëzojnë udhëzimet programatike të frymëzuara nga projekti për të përcaktuar planet e tyre.

La cooperazione italiana e le ONG coinvolte nel progetto sono consapevoli dell'importanza di assicurare continuità al lavoro svolto, anche tramite l'opportuna mobilitazione di ulteriori attori, quali gli enti locali italiani. Nei territori visitati è molto avvertito il desiderio di stabilire relazioni concrete di collaborazione con l'Italia, soprattutto con le regioni del nostro paese per le quali il turismo e la valorizzazione delle risorse naturali rappresentano asset prioritari per lo sviluppo economico.

I grant e i prestiti sono stati erogati sulla base di criteri pre-definiti e di decisioni trasparenti da parte del comitato di gestione dove, tra i vari soggetti rappresentati, vi sono le ONG VIS e CESVI, PfD, gli enti locali, l'entità micro finanziaria (Fondi BESA). Si aggiunge che non risultano casi di contestazione delle decisioni assunte dal comitato, a conferma della chiarezza del suo operato.

Fatte queste premesse, in previsione di ulteriori progetti analoghi, si raccomanda una maggiore condivisione tra gli stakeholders chiave circa i criteri tramite i quali selezionare sia i beneficiari e sia i progetti da finanziare con ognuno dei due strumenti. Tali criteri sono infatti stati esposti in modo differenziato nel corso degli incontri svolti durante la valutazione. In alcuni casi, soprattutto da parte degli enti locali, si è evidenziato il fatto che mentre i grant rappresentano strumenti decisamente orientati verso lo sviluppo imprenditoriale e si rivolgono a persone in grado di cofinanziare gli investimenti, i prestiti servono a risolvere problematiche contingenti, non sempre legate al rafforzamento dell'impresa. Opinione diversa è stata invece espressa da altri attori, quali PfD e Fondi BESA. Nella sostanza, una volta ascoltati i beneficiari nelle due aree progettuali, la forte percezione ricavata è che i due strumenti si siano efficacemente integrati, ma si suggerisce di approfondire il tema con tutti gli stakeholders per aggiornare, sulla base della positiva esperienza acquisita, i criteri di selezione dei beneficiari e degli investimenti per ognuno dei due strumenti.

Kooperacioni Italian dhe OJQ-të e përfshira në projekt janë të vetëdijshëm për rëndësinë e të siguruarit të vazhdimësisë së punës së kryer, edhe përmes mobilizimit të duhur të aktorëve (stakeholders) të tjerë, si autoritetet vendore italiane. Në territoret e vizituara është ndjerë shumë dëshira për të vendosur marrëdhënie konkrete bashkëpunimi me Italinë, sidomos me rajonet e vendit tonë, për të cilat turizmi dhe vlerësimi i burimeve natyrore paraqesin një aset prioritar për zhvillimin ekonomik.

Grantet dhe kreditë janë dhënë mbi bazën e kritereve të paracaktuara dhe të vendimeve transparente nga ana e Komitetit të Menaxhimit të Fondit, ku mes subjekteve të ndryshme të përfaqësuara janë OJQ-të VIS dhe CESVI, PfD, autoritetet vendore, subjekti mikro-financiar (Fondi BESA). Shtojmë këtu se nuk ka pasur raste kundërshtimi të vendimeve të marra nga komiteti, duke konfirmuar qartësinë e punës së tij.

Bazuar në sa më sipër, në pritje të projekteve të mëtejshme të ngjashme, rekomandohet një bashkëndarje më e madhe mes aktorëve (stakeholders) kyç në lidhje me kriteret me të cilat të zgjidhen si përfituesit ashtu edhe projektet që do të financohen me secilin prej dy instrumenteve. Këto kritere janë vënë në dukje në fakt në mënyra të ndryshme gjatë takimeve të kryera në procesin e vlerësimit. Në disa raste, sidomos nga ana e autoriteteve vendore, u theksua fakti që ndërsa grantet përfaqësojnë një instrument padyshim të orientuar drejt zhvillimit të sipërmarrjeve dhe u drejtohen personave të cilët janë në gjendje të bashkëfinancojnë investimet, kreditë shërbejnë për të zgjidhur problematika të mundshme, jo gjithmonë të lidhura me fuqizimin e ndërmarrjes/biznesit.Ndërkohë që një mendim ndryshe u shpreh nga aktorë të tjerë, të tillë si PfD dhe Fondi BESA. Në thelb, pasi u dëgjuan përfituesit në të dyja zonat e projektit, perceptimi i fortë që doli prej tyre është që të dy instrumentet janë integruar në mënyrë efikase, por sugjerohet që të analizohet thellë çështja me të gjithë aktorët (stakeholders) për të përditësuar, bazuar në përvojën pozitive të fituar, kriteret e përzgjedhjes të përfituesve dhe të investimeve për secilin nga dy instrumentet.

2. La teoria del cambiamento del progetto

Teoria e ndryshimit të projektit

Va aggiunto il fatto che l'alto livello di sostenibilità evidenziato dal micro credito rende possibile pianificare ulteriori prestiti a conclusione del progetto, per altro per gli stessi obiettivi e scopi del progetto cosi come previsto dall'accordo di collaborazione tra VIS – Cesvi e Fondi BESA. E' in corso tra gli stessi in accordo con l'AICS la definizione nel dettaglio dei criteri e delle modalità di gestione del servizio dopo il progetto,

Duhet shtuar fakti se niveli i lartë i qëndrueshmërisë i nxjerrë në pah nga mikrokredia bën të mundur planifikimin e mëtejshëm të kredive në përfundim të projektit, për më tepër për të njëjtat qëllime dhe objektiva të projektit, siç parashikohet nga marrëveshja e bashkëpunimit mes VIS – Cesvi dhe Fondi BESA. Është në vazhdim, mes palëve në marrëveshje me AICS, përcaktimi në detaje i kritereve dhe modaliteteve të menaxhimit të shërbimit pas projektit

Nel corso della valutazione è stata ricostruita, con la partecipazione attiva degli operatori delle ONG VIS e CESVI e tramite l'analisi della documentazione sulle attività realizzate, la teoria del cambiamento del progetto. Si propone a seguire questa ricostruzione, articolata nelle seguenti quattro dimensioni: a) interpretazione del contesto. Rientrano in questa dimensione l'identificazione degli alleati, cioè degli stakeholders chiave con i quali condividere gli obiettivi e l'identificazione del macro problema che il progetto intende contribuire a risolvere; b) definizione del cambiamento. Fanno parte di questa dimensione l'obiettivo generale, gli outcomes previsti, cioè i cambiamenti concreti da determinare, l'identificazione degli stakeholders primari, cioè delle categorie di persone direttamente interessate dal progetto e l'identificazione degli stakeholders secondari, cioè di coloro che traggono indirettamente beneficio dal progetto; c) le tesi e le assumptions. In questo caso l'attenzione è posta sulle relazioni di "causa effetto" tra attività e outputs, intesi come precondizioni del cambiamento, (gli outcomes); d) la visione globale, anche definita "meta teoria del cambiamento" alla quale il progetto si è ispirato.

Gjatë fazës së vlerësimit u rindërtua, me pjesëmarrjen aktive të operatorëve të OJQ-ve VIS dhe CESVI dhe nga analiza dhe shqyrtimi i dokumentacionit të aktivitetevetë realizuara, teoria e ndryshimit të projektit. Propozohet të ndiqet ky rindërtim, i ndarë në katër dimensionet e mëposhtme: a) Interpretimi i kontekstit. Bëjnë pjesë në këtë dimension identifikimi i aleatëve, pra i aktorëve (stakeholders) kyç me të cilët të ndahen objektivat dhe identifikimi i makro problemit që projekti synon të kontribuojë për ta zgjidhur; b) përcaktimi i ndryshimit. Janë pjesë e këtij dimensioni objektivi i përgjithshëm, objektivat e pritshëm specifikë (outcomes), që janë ndryshimet konkrete për t'u përcaktuar, identifikimi i aktorëve (stakeholders) kryesorë, d.m.th. kategoritë e personave të prekur drejtpërsëdrejti nga projekti dhe identifikimi i aktorëve (stakeholders) dytësorë, d.m.th. ata që përfitojnë indirekt nga projekti; c) argumentet dhe supozimet (assumptions). Në këtë rast, vëmendja përqendrohet në marrëdhëniet e "shkakut dhe pasojës" mes aktiviteteve dhe rezultateve (outputs), të kuptuara si parakushte të ndryshimit, (objektivat specifikë/outcomes); d) vizioni global, i quajtur edhe "filozofia bazë e teorisë së ndryshimit", në të cilën projekti është frymëzuar.

INTERPRETAZIONE DEL CONTESTO
INTERPRETIMI I KONTEKSTIT

Si è partiti dall'identificazione degli Stakeholders chiave, dal cui operato può dipendere il successo del progetto e con i quali condividere in prima istanza l'analisi dei problemi da risolvere. Sono stati quindi identificati i rappresentanti degli enti locali e i leader comunitari e di villaggio riconosciuti dalle comunità e dalle istituzioni, l'istituzione micro finanziaria e la fondazione Partnership for Development, una delle più accreditate agenzie dell'Albania nel campo dello sviluppo rurale. Si è quindi sviluppato un rapporto di partenariato ispirato dalla condivisione di interessi strategici. I partner del progetto sono gli stakeholderschiave.

Si sono quindi messi a fuoco, tramite interviste, analisi, incontri e scambi con gli stakeholders chiave i "macro problemi" da affrontare e risolvere: l'esclusione delle aree del progetto dalle dinamiche dell'economia di mercato, "abbracciate" dall'Albania dal 1991, la mancanza di servizi dovuta all'assenza o all'inefficienza dello Stato, la forte spinta migratoria da parte dei giovani dovuta alla mancanza di opportunità. Il progetto si ispira all'Obiettivo di Sviluppo Sostenibile n. 10 dell'agenda 2030 adottata dalle Nazioni Unite nel Settembre 2015 perché punta a ridurre le diseguaglianze tra aree, comunità e gruppi sociali all'interno dell'Albania.

U fillua nga identifikimi i aktorëve (stakeholders) kyç, nga puna e të cilëve mund të varet suksesi i projektit dhe me të cilët të ndahet në radhë të parë analiza e problemeve për t'u zgjidhur. U identifikuan përfaqësuesit e autoriteteve vendore dhe kryepleqtë (leader komunitarë dhe fshatrash) të njohur nga komuniteti dhe institucionet, instituti mikro financiar dhe Fondacioni Partneritetit për Zhvillim, një nga agjencitë më të besueshme të Shqipërisë në fushën e zhvillimit rural. U zhvillua një marrëdhënie partneriteti e frymëzuar nga interesat e përbashkëta strategjike. Partnerët e projektit janë aktorët (stakeholders) kryesorë.

Prandaj, përmes intervistave, analizave, takimeve dhe shkëmbimeve me aktorët (stakeholders) kryesorë, u vunë në fokus "makro problemet" për t'u përballuar dhe zgjidhur: përjashtimi i zonave të projektit nga dinamikat e ekonomisë së tregut, "të përqafuara" nga Shqipëria pas vitit 1991, mungesa e shërbimeve për shkak të mungesës ose të paaftësisë dhe mosefikasitetit të Shtetit, lëvizja e fortë migratore nga ana e të rinjve për shkak të mungesës së mundësive. Projekti frymëzohet nga Objektivi nr. 10 i Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030 të miratuar nga Kombet e Bashkuara në shtator 2015 sepse synon të zvogëlojë pabarazitë mes zonave, komuniteteve dhe grupeve shoqërore brenda Shqipërisë.

DEFINIZIONE DEL CAMBIAMENTO
PËRKUFIZIMI I NDRYSHIMIT

Sono stati ricostruiti un obiettivo generale e tre outcomes, cioè tre dimensioni concrete del cambiamento auspicato. Assieme agli stakeholders chiave si è stabilito che il progetto dovesse contribuire al miglioramento delle condizioni socio-economiche dei distretti di Malesi e Ma dhe e di Permet e delle aree montane limitrofe attraverso la valorizzazione delle risorse locali. Affinché questo obiettivo sia effettivamente sos-

U rindërtuan një objektiv i përgjithshëm dhe tre objektiva specifikë (outcomes), d.m.th. tre dimensione konkrete të ndryshimit të kërkuar. Së bashku me aktorët (stakeholders) kyç u vendos që projekti duhet të kontribuojë në përmirësimin e kushteve socio-ekonomike të rretheve të Malësisë së Madhe dhe Përmetit dhe zonat malore kufitare përreth tyre përmes vlerësimit të burimeve vendore. Për të bërë të mundur që

tenuto, è necessario ottenere tre cambiamenti: (i) maggiore competitività economica delle aree del progetto; (ii) rafforzamento del tessuto produttivo, soprattutto tramite il miglioramento dell'offerta agro turistica; (iii) rafforzamento della partecipazione popolare ai processi di sviluppo e alla creazione di una rete di comunicazioni e scambi tra le comunità locali.

ky objektiv të jetë i mbështetur në mënyrë efektive, duhet të merren tre ndryshime: (i) konkurrencë më të madhe ekonomike të zonave të projektit; (ii) forcimi i sektorit prodhues, sidomos nëpërmjet përmirësimit të ofertës agro-turistike; (iii) forcimi i pjesëmarrjes popullore në proceset e zhvillimit dhe krijimi i një rrjeti komunikimesh dhe shkëmbimesh ndërmjet komuniteteve vendore.



Valorizzazione delle risorse locali/Vlerësimi i burimeve vendore

Sono stati identificati come stakeholders primari: piccoli imprenditori, utenti dei servizi di base (studenti, insegnanti), comunità prive di servizi essenziali (ad esempio l'acqua). L'identificazione degli stakeholders secondari è avvenuta progressivamente nel corso del progetto. Oggi possiamo includere in questa categoria: giovani spinti verso la migrazione come sola possibilità di avere una vita economicamente attiva, clienti delle attività economiche sostenute, operatori economici non direttamente sostenuti che hanno tratto beneficio dal progetto e dall'impulso dato al turismo (ad esempio operatori nel campo dei trasporti).

U identifikuan si aktorë (stakeholders) kryesorë: sipërmarrës të vegjës, përdoruesit e shërbimeve bazë (nxënës/studentë, mësues), komunitete të cilave u mungojnë shërbimet bazë (si për shembull uji). Identifikimi i aktorëve (stakeholders) dytësorë u bënë mënyrë progresive gjatë zbatimit të projektit. Sot mund të përfshijmë në këtë kategori: të rinj të shtyrë drejt emigracionit, që e shohin këtë si të vetmen mundësi për të pasur një jetë ekonomikisht aktive, klientë të aktiviteteve ekonomike të mbështetura, operatorë ekonomikë jo drejpërdrejtë të mbështetur që kanë përfituar nga projekti dhe nga impulsi i dhënë turizmit (p.sh. operatorët në fushën e transportit).

LE TESI E LE ASSUMPTIONS
ARGUMENTET DHE SUPOZIMET

Il progetto ha assunto, sulla base dell'analisi del contesto, che le attività conducessero a specifici outputs e che questi rappresentassero vere e proprie pre-condizioni per il raggiungimento degli outcomes, cioè dei cambiamenti sociali auspicati. Le relazioni "causa – effetto" assunte inizialmente appaiono oggi confermate e si possono arricchire con ulteriori elementi di valutazione. Senza riportare in questa sede il quadro logico del progetto, ci si concentra sulle seguenti relazioni: a) le attività di animazione socio-economica, di informazione, di micro credito e di erogazione dei grant hanno reso possibile ampliare l'accesso alle risorse finanziarie a fini produttivi; b) le attività di sostegno alle iniziative comunitarie hanno migliorato ed esteso l'accesso ai servizi e ai beni essenziali; c) le attività di assistenza tecnica e di formazione hanno consentito di migliorare lo standard qualitativo dei prodotti e dei servizi agro turistici; d) le attività di sostegno e promozione delle potenzialità naturalistiche e culturali hanno consentito di determinare lo sviluppo dell'agriturismo e del turismo culturale. Oggi, se il progetto dovesse essere riscritto, si potrebbe eliminare dal titolo l'aggettivo "marginali", sostituendolo con l'espressione "in trasformazione". Questa non è solo l'opinione di chi ha elaborato il rapporto, ma anche

Projekti ka marrë përsipër, bazuar në analizën e kontekstit, që aktivitetet të çonin në rezultate (outputs) specifike dhe që këta të përfaqësonin parakushte të vërteta për arritjen e e objektivave specifikë, pra ndryshimet e dëshiruara sociale. Marrëdhëniet e dëshiruara "shkak-pasojë", të marra fillimisht shfaqen sot të konfirmuara dhe mund të pasurohen me elementë të mëtejshëm vlerësimi. Pa sjellë këtu kuadrin logjik të projektit, fokusohemi në marrëdhëniet e mëposhtme: a) aktivitetet e animacionit socio-ekonomik, të informimit, të mikro-kredisë dhe të dhënies së granteve kanë bërë të mundur zgjerimin e qasjes në burimet financiare për qëllime prodhuese; b) aktivitetet në mbështetje të nismave komunitare kanë përmirësuar dhe shtrirë qasjen në shërbime dhe në të mirat thelbësore; c) aktivitetet e asistencës teknike dhe trajnimit/formimit kanë përmirësuar standardet e cilësisë së produkteve dhe të shërbimeve agro-turistike; d) aktivitetet për mbështetjen dhe promovimin e potencialeve natyrore dhe kulturore kanë ndihmuar në zhvillimin e agro-turizmit dhe turizmit kulturor. Sot, nëse projekti do të duhej të rishkruhej, do të mund të hiqej termi "margjinalizuara", duke e zëvendësuar me shprehjen "në ndryshim". Ky nuk është vetëm mendimi i atij që ka shkruar raportin, por është opinioni edhe i të gjithë per-

quella di tutti gli interlocutori incontrati.

Il progetto ha inoltre accettato due sfide: la sostenibilità del credito erogato e la possibilità che i suoi interventi venissero inglobati nei piani e nelle strategie di sviluppo degli enti territoriali di riferimento. Come si spiegherà nei capitoli successivi, le sfide appaiono vinte. Le tesi assunte, in questo caso, sono state: i) la sostenibilità del credito, più che dalle garanzie patrimoniali offerte dai creditori (peraltro complesse, data l'incertezza dei titoli di proprietà dei clienti – beneficiari) sarebbe dipesa dalla pressione comunitaria e dalla credibilità sociale ed etica dei soggetti selezionati, oltre che dalla viabilità dei loro progetti economici; ii) integrando strategicamente la risposta ai bisogni del territorio e la co-gestione delle attività con gli amministratori pubblici il progetto avrebbe potuto contribuire a ridurre la distanza tra questi ultimi e le comunità locali, facendo ad esse percepire non solo il vantaggio di una qualificata assistenza di cooperazione ma anche, forse per la prima volta, l'affidabile presenza dello stato, tramite le sue articolazioni locali. Come si potrà successivamente osservare, i municipi coinvolti stanno definendo i propri piani di sviluppo e assumeranno le lezioni apprese e le strategie del progetto come punti qualificanti dai quali partire.

sonave dhe bashkëbiseduesve të takuar.

Projekti ka pranuar edhe dy sfida: qëndrueshmërinë e kredisë dhe mundësinë që ndërhyrjet (aktivitetet) e tij ishin të përfshiheshin në planet dhe strategjitë e zhvillimit tëautoriteteve vendore që iu referohen. Siç do të shpjegohet në kapitujt që vijojnë, sfidat duken të fituara. Argumentat e marra, në këtë rast, ishin: i) qëndrueshmëria e kredisë, më tepër se nga garancitë e kapitalit të ofruara nga kreditorët (për më tepër komplekse, duke pasur parasysh pasigurinë e titujve të pronësisë të klientëve – përfituesve) do të varej nga presioni komunitar dhe nga besueshmëria sociale dhe etike e subjekteve të përzgjedhura, si dhe nga zbatueshmëria dhe qëndrueshmëria e projekteve të tyre ekonomike; ii) duke integruar në mënyrë strategjike përgjigjen ndaj nevojave të territorit dhe bashkë-menaxhimin e aktiviteteve me administratorët projekti do të mund të kontribuonte në uljen e largësisë midis këtyre të fundit dhe komunitetit vendas, duke i bërë ata të ndjenin jo vetëm avantazhin e një asistence të kualifikuar bashkëpunimi por edhe, ndoshta për herë të parë, praninë e besueshme të shtetit, përmes nyjeve të saj vendore. Siç do ta vini re në vijim, bashkitë e përfshira janë duke përcaktuar planet e tyre të zhvillimit dhe do të marrin mësimet e nxjerra dhe strategjitë e projektit si pika kyçe për të filluar.

LA VISIONE GLOBALE

VIZIONI I PËRGJITHSHËM

A Malesi e Madhe e a Permet le operatrici e gli operatori del progetto hanno espresso le loro speranze per il futuro dei territori, che riassumiamo a seguire.

Vogliamo più presenza dello Stato, perché solo tramite questa possono essere assicurati servizi essenziali, quali l'elettricità e le strade. Vogliamo territori più conosciuti all'esterno e nei quali la gente si senta orgogliosa di vivere e di lavorare. Vogliamo che i giovani non si sentano costretti ad emigrare e che avvertano la concreta possibilità di costruire il proprio futuro nel loro territorio. Vogliamo che i consorzi esistenti si rafforzino e che accrescano la qualità della loro produzione. Vogliamo maggiori collegamenti tra i territori ed il mondo esterno. Vogliamo più sensibilità e consapevolezza da parte di tutti che l'ambiente è una risorsa da proteggere e valorizzare e non un ostacolo allo sviluppo. Vogliamo amministratori pubblici più competenti e più attenti ai bisogni delle comunità. Vogliamo vedere rafforzata l'offerta turistica ed estesi i benefici economici dei parchi e delle risorse naturali. Vogliamo la rinascita dei lavori artigianali e una maggiore vitalità dei villaggi.
La visione globale del progetto si ispira a queste speranze. Le cinque parole chiave sono: riscatto, ownership, giovani, ambiente, stato. A seguire si riporta, usando i concetti dei suoi operatori, la mission del progetto.

Në Malësi të Madhe dhe në Përmet punonjësët dhe punonjësit e projektit shprehën shpresat e tyre për të ardhmen e territoreve, të cilat përmblidhen si më poshtë:

Dëshirojmë që Shteti të jetë më i pranishëm, sepse vetëm përmes pranisë së tij mund të garantohen shërbimet bazike, siç janë energjia elektrike dhe rrugët. Duam territore më të njohura jashtë dhe në të cilat njerëzit të ndihen krenarë që jetojnë dhe punojnë. Dëshirojmë që të rinjtë të mos ndihen të shtrënguar të emigrojnë dhe që ta shohin mundësinë për të ndërtuar të ardhmen e tyre në tokën e tyre. Dëshirojmë që konsorciumet ekzistuese të forcohen dhe të rrisin cilësinë e produkteve të tyre. Dëshirojmë më tepër lidhje mes territoreve dhe botës jashtë. Dëshirojmë më shumë ndjeshmëri dhe vetëdijësim nga ana e të gjithëve për mjedisin, që është një burim për t'u mbrojtur dhe vlerësuar dhe jo një pengesë për zhvillim. Dëshirojmë administratorë publikë më kompetentë dhe më të vëmendshëm ndaj nevojave të komunitetit. Dëshirojmë ta shohim të forcuar ofertën turistike dhe të shtrira përfitimet ekonomike të parqeve dhe të burimeve natyrore. Dëshirojmë rijetëzimin e punimeve artizanale dhe një gjallërim më të madh të fshatrave.
Vizioni i përgjithshëm i projektit frymëzohet në këto shpresa. 5 fjalët kyç janë: shpërblesë, pronësi (ownership), rini, mjedis, shtet. Më poshtë paraqitet duke përdorur konceptet e operatorëve të tij, misioni i projektit.

Ogni territorio deve essere integrato nello sviluppo sociale ed economico del paese, ai fini della giustizia, dell'equità e della stabilità. Tramite l'impulso allo sviluppo economico centrato sulle risorse del territorio le comunità possono sviluppare un senso di appartenenza e rafforzare la coesione sociale. Lo sviluppo deve guardare soprattutto ai giovani, che hanno diritto, se lo desiderano, a rimanere nel loro paese e a non essere costretti ad emigrare. La migrazione deve essere una scelta, non una fuga. Lo sviluppo si può e si deve costruire valorizzando le risorse naturali e culturali dei territori, che quindi vanno protette. Occorre rafforzare il rapporto tra cittadini, stato e pubblica amministrazione. La società civile ha una funzione essenziale ma non può sostituirsi alle istituzioni.
Tutto questo è possibile. Si tratta di speranze, non di sogni.

Çdo territor duhet të integrohet në zhvillimin social dhe ekonomik të vendit, me qëllim drejtësinë, barazinë dhe stabilitetin. Nëpërmjet shtysës për zhvillimin ekonomiktë përqendruar në burimet e territorit, komunitetet mund të zhvillojnë një ndjenjë përkatësie dhe të forcojnë kohezionin social. Zhvillimi duhet t'u drejtohet kryesisht të rinjve, të cilët kanë të drejtë, në qoftë se ata dëshirojnë, të qëndrojnë në vendin e tyre dhe të mos jenë të detyruar të emigrojnë. Migrimi duhet të jetë një zgjedhje, jo një ikje e detyruar. Zhvillimi mund dhe duhet të ndërtohet duke vlerësuar burimet natyrore dhe kulturore të territoreve, të cilat për këtë arsye duhet të jenë të mbrojtura. Nevojitet të forcohet marrëdhënia mes qytetarëve, shtetit dhe administratës publike. Shoqëria civile ka një rol thelbësor, por ajo nuk mund të zëvendësojë institucionet.
E gjithë kjo është e mundur. Bëhet fjalë për shpresa, jo për ëndrra.

3. RIFERIMENTI ALLA METODOLOGIA DELLA VALUTAZIONE

REFERENCA PËR METODOLOGJINË E PROJEKTIT

Il rapporto presenta i risultati di un'auto valutazione, cioè di un'analisi ispirata essenzialmente alle riflessioni e alle risposte degli stakeholders del progetto, inclusi i beneficiari. Questo esercizio è stato facilitato da esperti esterni, cioè non appartenenti ad alcuna delle organizzazioni implementatrici. Inevitabilmente al compito di facilitare il percorso valutativo si è sommata la partecipazione a tale percorso. Pertanto il rapporto riflette anche, significativamente, opinioni "esterne"; ciò configura di fatto l'esercizio presentato come un mix tra auto valutazione e valutazione esterna.

La valutazione ha avuto luogo in Albania dal 22 al 26 Aprile 2017, a poco più di un mese di distanza dalla conclusione del progetto. Le località visitate, le istituzioni e le persone incontrate sono indicate nell'allegato B.

Raporti paraqet rezultatet e një vetëvlerësimi, që është në thelb një analizë e frymëzuar nga reflektimet dhe përgjigjet e reagimet e palëve të interesuara (stakeholders) të projektit, duke përfshirë përfituesit. Ky ushtrim u lehtësua nga ekspertë të jashtëm, që nuk i përkasin asnjë prej organizatave zbatuese të tij. Në mënyrë të pashmangshme detyrës për lehtësimin e procesit të vlerësimit iu bashkua edhe pjesëmarrja në këtë rrugëtim e proces. Prandaj, raporti pasqyron gjithashtu në mënyrë të konsiderueshme, mendime "të jashtme"; kjo e bën në fakt ushtrimin e paraqitur si një përzierje (mix) mes vetëvlerësimit dhe vlerësimit të jashtëm.

Vlerësimi u krye në Shqipëri nga data 22 deri më 26 prill 2017, në pak më shumë se një muaj nga përfundimi i projektit. Vendet e vizituara dhe personat e takuar janë paraqitur në Shtojcën B.





Lo sforzo fatto è stato quello di arricchire l'esercizio valutativo con la partecipazione attiva di rappresentanti di tutti gli stakeholders chiave e primari, che sono stati coinvolti non solo come "erogatori di informazioni e opinioni" ma anche come corresponsabili della logica d'insieme dell'esercizio. In concreto, durante gli incontri, si è chiarito, ad esempio, quali informazioni servissero ad analizzare ognuna delle cinque dimensioni della valutazione appresso indicate. In questo modo, la valutazione si è anche tradotta in un percorso formativo, laddove tutti gli interlocutori hanno avuto modo di conoscere e discutere i criteri e la metodologia utilizzati.

Il ruolo degli esperti esterni si è articolato nel modo a seguire: elaborazione e proposta dell'impianto metodologico; coordinamento degli incontri in Albania con i beneficiari; stesura del draft del rapporto.

Prima di procedere agli incontri nel nord e nel sud del paese, è stata svolta un'approfondita analisi della documentazione del progetto. In particolare, insieme allo staff del VIS a Tirana sono stati analizzati, oltre al testo del progetto e ai rapporti inviati alla Cooperazione Italiana (che erano stati già studiati in Italia), documenti "chiave", quali il cronogramma aggiornato, lo stato di avanzamento della contabilità del progetto, i rapporti di revisione contabile, la documentazione relativa alle operazioni di procurement, i contratti con il personale albanese, l'accordo operativo tra le parti "Vademecum di gestione del progetto", il Manuale delle procedure del Fondo per lo Sviluppo Locale.

Gli incontri sono stati svolti sulla base di griglie tematiche e si sono poi arricchiti di tematiche scaturite dalla discussione, non sempre inizialmente previste. Per quanto concerne gli incontri con gli enti territoriali, i principali temi affrontati sono stati:

• Problematiche sociali ed economiche prioritarie nei territori;
• Potenzialità di sviluppo ancora non valorizzate dei territori;
• Principali piani di sviluppo per i territori;
• Integrazione del progetto nei piani di sviluppo;

Përpjekja e bërë ishte ajo për të pasuruar ushtrimin e vlerësimit me pjesëmarrjen aktive të përfaqësuesve të të gjithë aktorëve dhe palëve të interesuara (stakeholders) kyç dhe parësorë, që kanë qenë të përfshirë jo vetëm si "ofrues informacionesh dhe mendimesh", por edhe si bashkëpërgjegjës për logjikën e përgjithshme të ushtrimit. Konkretisht, gjatë gjithë takimeve, u bë e qartë, për shembull, cilat informacione shërbejnë për të analizuar secilën prej dimensioneve të vlerësimit të paraqitura. Në këtë mënyrë, vlerësimi shërbeu edhe si një kurs formimi, aty ku të gjithë bashkëbiseduesit patën mundësinë të njohin dhe diskutojnë kriteret dhe metodologjinë e përdorur.

Roli i ekspertëve të jashtëm u organizua në mënyrën që vijon: përpunimi dhe propozimi i procesit të metolologjisë; koordinimi i takimeve me përfituesit në Shqipëri; hartimi i draft raportit.

Para se të vijohej me takimet në veri dhe jug të vendit, u krye një analizë e plotë e dokumentacionit të projektit. Në veçanti, së bashku me stafin e VIS në Tiranë u analizuan përveç tekstit të projektit dhe raportet e dërguara Kooperacioni Italian (që ishin studiuar tashmë në Itali), dokumente "kyç", të tilla si kalendari i aktiviteteve (afatet kohore) i përditësuar, ecuria e kontabilitetit të projektit, raportet e auditimit, dokumentacioni mbi veprimet e prokurimit, kontratat me personelin shqiptar, marrëveshja operative mes palëve "Manuali për menaxhimin e projektit" (vademecum), Manuali i Procedurave të Fondit të Zhvillimit Lokal.

Takimet u kryen në bazë të fushave tematike dhe u pasuruan me tematika të dala nga diskutimet, jo gjithmonë të planifikuara fillimisht. Për sa i përket takimeve me autoritetet vendore, temat kryesore të trajtuara ishin:

• Problematikat sociale dhe ekonomike prioritare të territoreve;
• Mundësitë (potencialet) e zhvillimit ende të pashfrytëzuara të territoreve;
• Planet kryesore të zhvillimit për territoret;
• Integrimi i projektit në planet e zhvillimit;
• Kontributi i dhënë nga projekti për zgjidhjen e problemeve sociale dhe ekonomike të terri-

• Contributo dato dal progetto alla soluzione dei problemi sociali ed economici del territorio;
• Livello di collaborazione del personale del progetto;
• Livello di conoscenza delle strategie del progetto.

